



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve
Periudha raportuese	Muaji Shkurt 2024
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Znj. Donika Çetta Drejtoreshë e Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve

1.PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve ka vazhduar përgjatë muajit Shkurt realizimin e detyrave të caktuara në bazë të planit të punës për rekultivimin e hapësirave të gjelbërta si dhe krijimin e hapësirave të reja të gjelbërta dhe parqeve në Komunën e Prishtinës.

2.AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit dhe fushes së veprimit të Komunës për drejtorinë e Parqeve:

- Përcjellja – mbikëqyrja e punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në qytet nga ana e NPL “Gjelbër”, dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërta brenda territorit të Komunës së Prishtinës; krasitja e drunjëve që paraqesin rrezik nga rrëzimi i tyre;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave të parqeve për aktivitete;
- Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e Qendrës Rekreative “Gërmia” për aktivitete sensibilizuese dhe edukuese;
- Pranimi i kërkesave dhe ankesave nga qytetarët, shqyrtimi i tyre edhe nga subjektet tjera komunale dhe dërgimi i tyre për personin apo subjektin që i dedikohen;

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR -

- Identifikimi i hapësirave publike për rigjenerim të tyre përmes projekteve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në parqet ekzistuese;
- Hartimi i Planit të Veprimit për vitin 2024;
- Përgatitja e projekteve për tenderim;
- Mbikqyrja e punëve në Parkun e Drenocit;
- Rifillimi i punëve në Pakrun Linear;
- Shtrirja e sistemit të ujitjes dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;
- Regjenerimi I hapësirës gjelberuese tek ish-objekti Gërmia;

5. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Numri i lëndëve të pranuar: 11

Numri i lëndëve të kryera: 7

Numri i lëndëve të refuzuara: 0

Numri i lëndëve të ceduara: 0

Numri i lëndëve në proces: 9

6. Takime të tjera:

- Konferencë për projektet me UNDP përmes City Experiment Fund në Bratislavë;
- Takim me Klubin Alpin Prishtina;
- Takim me N.p.l. Gjelbër;
- Takim me SLK;
- Takim me Drejtoritë tjera për Bashkupime të ndryshme;

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES –

- Përgatitja dhe inicimi i projekteve për tenderim;

